



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:073924  
Datë: 25.02.2019  
Numri i dokumentit: 00232455

*P. nr. 114/2019*

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm,** sipas gjykatësit të vetëm gjykues Luljete Shabani, sek. juridike, Rafete Sylja, në çështjen penale kundër të akuzurit N.N nga P....., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av....., për shkak të veprës penale, **Sulmi, nga neni 187, par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-së,** e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.141/19, të datës 30.01.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, oral dhe publik, lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, e lidhur në mes palëve procedurale, të dt.30.01.2019, më datën 22.02.2019, bie dhe në presencë të palëve, publikisht shpall, ndërsa, më dt. 25.02.2019, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari N.N., nga i ati A.... dhe nëna Z..., e lindur P.... i lindur më datë .... në G...., jeton në fsh. P...., K. e P..., me nr. letërnjoftimi ....., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse, më datën 24.01.2019, rreth orës 16.30 min. në fsh. P..., K. e P....., me dashje ka përdorë forcë ndaj babait të tij, tani të dëmtuarit A.... J...., duke shkaktuar dhunë në familje, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që kishin pasur mes vete, e ka shtyer me dorë, e më pas e ka sulmuar duke e goditur me duar dhe shkelma në kokë dhe pjesë të ndryshme të trupit, me ç'rast, i ka shkaktuar dhembje, mundim, frikë dhe shqetësim

- me çka ka kryer veprë penale **Sulmi, nga neni 187, par. 3, lidhur me par.1 të KPRK-së,** andaj, Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7,17,21,51,73,114,të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-ës.

## **E G J Y K O N M E D Ë N I M M E K U S H T**

Të akuzuarin....., me **Dënim Burgu** në kohëzgjatje prej **180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve,** e i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej **18 (tetëmbëdhjetë) muajve** nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë.

Obligohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej **10 (dhjetë) €,** si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan,-Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzë PP. II.nr. 141/19, të datës 30.01.2019, kundër të akuzuarit....., për shkak të veprës penale, Sulmi, nga neni 187, paragrafi 3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë, si dhe të sanksionit penal, i është paraqitur gjykatëses, në pajtim me nenin 233 të KPPRK-së, më dt. 30.01.2019, e të cilat si të tëra, janë pjesë përbërëse e kësaj lënde penale. Për veprën penale, Sulmi, nga neni 187, par. 3 lidhur me par.1, është paraparë dënimi me burgim deri në tri vjet.

Përfaqësuesja e aktakuzës, prokurorja, Huma Jetishi, e ka njoftuar gjykatësen e vetme gjykuese për dhënjen e pëlqimit me shkrim nga ana e kryeprokurorit dhe për lidhjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe sanksionin penal, duke hequr dorë nga dëgjimi mi dëshmitarëve dhe shtjellimit të provave të tjera materiale.

Mbrojtësi i të akuzuarit....., ....dhe i akuzuari....., e kanë njoftuar, poashtu gjykatësin e vetëm gjykues për marrëveshjen në fjalë, duke hequr dorë nga dorë nga dëgjimi i dëshmitarëve dhe shtjellimi i provave të tjera materiale, poashtu, duke u pajtuar që dënimi i të akuzuarit Nenad Jançiq, të jetë Dënimi me kusht, me njëqind e tetëdhjetë ditë, për 18 muaj.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë, i përmban të gjitha kushtet, duke bërë propozim për marrëveshjen e pranimit të fajësisë dhe sanksionit penal, e bërë në mënyrë vullnetare, duke deklaruar edhe për arsyet e pranimit të fajësisë.

Gjykata ka gjetur se palët procedurale marrëveshjen në fjalë e kanë bërë në pajtim me nenin 233 të KPPRK-së.

Pasi që palët procedurale, prokurori i shtetit, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, e kanë arritur marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe të sanksionit penal, gjykata atë e pranoi pa hezitim, si të arritur me vullnet nga palët.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimin ndaj të akuzuarit, gjykatësi mori për bazë marrëveshjen mbi pranimin vullnetar të fajësisë dhe sanksionit penal nga i akuzuari, si

*dhe, rrethanat tjera lehtësuese, si sjelljen korrekte të të akuzuarit në Gjykatë, pendimin e tij, si dhe prmtiminse një gjë të tillë nuk do ta përsërisë, hera e parë që është ndeshur me ligjin, ndërsa, si rrethana rënduese, rrezikshmërinë shoqërore të këtyre veprave penale, si dhe peshën e përgjegjësisë penale.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.*

*Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
P.nr. 114/19 më datë 25.02.2019**

**Sek. Juridike,**  
Rafete Syla

**Gjykatësi i vetëm gjykues,**  
Luljete Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njejtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.